REPUBLIC OF SLOVENIA
MINISTRY OF THE INTERIOR

CILC

LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJIT

RAPORT TREMUJOR 4

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

PËRPARIMI I MISIONIT VLERËSUES TË BE-SË PËR KËSHILLIN GJYQËSOR

„BISEDA PËR BARAZI "– PLATFORMË DIALOGU

TRAJNIM I IACA PËR ANTIKORRUPSION

BASHKËPUNIMI EFIKAS PËR ANTIKORRUPSION

DICIARY

LICE

GUSHT 2024

KLAUZOLË PËRJASHTIMI:
KY RAPORT ËSHTË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.

Financuar nga
Bashkimi Evropian

PARATHËNIE



Dieter SCHINDLAUER

Drejtues ekipi, "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit"

"Ne shfrytëzojmë këtë botim për të ruajtur një frymë të mirë dhe për të mbështetur një etikë besimi në arsyen e mirë për ndryshim, reformë dhe një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për ta bërë këtë, ne do të tregojmë hapat përpara në mënyrë të tillë që ata të mos humbasin në mesin e zhurmës mbizotëruese të lajmeve zhgënjyese".

Të nderuar lexues,
Për fat të mirë, edhe në këtë raport të tremujorit të katërt po vijmë me shumë lajme të mira.

Në këtë botim do të gjeni dëshmi për përpjekjet e mëdha për përparim të gjyqësorit, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe rritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sistemit të provës. Këto janë histori për bashkëpunim me dedikim të madh për një të ardhme të më të mirë përmes sistemeve dhe institucioneve që funksionojnë mirë.

Vlen të theksohet mënyra se si Këshilli Gjyqësor shpejt dhe me fokus të madh zbatoi rekomandimet e Misionit Vlerësues të BE-së dhe miratoi planin gjithëpërfshirës të veprimit, dhe strategjinë e komunikimit. Këto përpjekje u përshëndetën publikisht nga palët e vendit dhe nga palët ndërkombëtare gjatë ngjarjes që u mbajt në fillim të korrikut, ku poashtu u theksua që puna duhet të vazhdojë dhe që praktika ka nevojë për përmirësimë të mëtejshme. Poashtu, po ndajmë të rejat mbi ndryshimet e procedurës diciplinore për prokurorët publikë, një trajnim mjaft praktik për prokurorët publikë dhe hetuesit për punën në Darknet dhe një ngjarje tjetër ku ndahen praktikat më të mira dhe strategjitë inovative në luftën kundër korrupsionit.

PARATHËNIE

Mbi korrupsionin u diskutua edhe në modulin e parë të trajnimeve në bashkëpunim me Akademinë Ndërkombëtare të Antikorrupsionit, që u fokusua në shkeljet institucionale dhe që e ndoqën me sukses 20 pjesëmarrës nga të cilët pritet që të zbatojnë njohuritë e marra në 11 institucione të ndryshme ku punojnë.

Shërbimi i provës ndoqi trajnimin për komunikimin gjatë krizave, kurse Plani Nacional i Veprimit për gratë dhe vajzat rome ishte në fokusin e një ngjarjeje tjetër që u organizua nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Me tryezën e rrumbullakët në Kavadar u theksuan përfitimet nga bashkëpunimi efektiv mes autoriteteve lokale dhe institucionit të Avokatit të Popullit. Ngjarja e parë e ,,Bisedave të barazisë'' që u organizua bashkë me Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi trajtoi çështjet që lidhen me arsimimin gjithëpërfshirës sipas formatit të platformës së hapur që do të përsëritet me çështje të ndryshme dhe aktuale gjatë viteve në vijim. Në pjesën ,,Njihuni me ekipin'', kësaj radhe mund të shijoni njohuritë që jep udhëheqësi i komponentit për luftën kundër krimit të organizuar, hetuesi slloven me përvojë të gjatë, Robert Shpllajt.

Uroj që këto histori angazhimesh, kurajosh dhe kreativiteti i dëshmuar do ju duken interesante dhe do ju motivojnë edhe ju po aq sa më kanë motivuar mua.

Shijoni këto lajme të mira!



Diter Shindlauer
Uhëheqës i Ekipit

JU PARAQESIM:

PËRPARIMI I KËSHILLIT GJYQËSOR LIDHUR ME MISIONIN VLERËSUES TË BE-SË

Projekti ynë mirëpriti konferencën ku Këshilli bëri prezantimin e progresit të arritur lidhur me rekomandimet e Misionit Vlerësues të BE-së para përfaqësuesve të lartë të gjyqësorit, anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare, shoqatave juridike, odave, gazetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

BASHKËPUNIM EFIKAS PËR ANTIKORRUPSION

Ekspertët e policisë sllovene ndajnë praktikat më të mira dhe strategjitë me inovacion dhe inicojnë bashkëpunim institucional në politikat e Maqedonisë së Veriut për antikorrupsion.

„BISEDA PËR BARAZI “ – PLATFORMA E DIALOGUT

Në bashkëpunim me KPMD projekti ynë organizoi platformën e parë të hapur për dialog për trajtim të sfidave strukturore dhe sistemike për barazi dhe mosdiskriminim, e njohur si ,,Biseda për barazi“.

Të flasim pak për...

- Përparimin e gjyqësorit: përparim i Këshillit Gjyqësor në zbatimin e rekomandimeve të Misionit Vlerësues të BE-së
- Trajnim praktik mbi Darknet për prokurorët publikë dhe hetuesit në Maqedoninë e Veriut
- Këshilli i reformave në gjyqësi mban seancën inauguruese, forcon dedikimin e aspiratave për anëtarësim në BE
- Projekti ynë merr dhuratë pllakatin për bashkëpunim dhe mbështetje nga Shoqata e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Përgatiten ndryshimet e Rregullores mbi Procedurën Diciplinore
- Bashkëpunimi efikas mes Avokatit të Popullit dhe autoriteteve lokale në Kavadar forcojnë të drejtat e njeriut dhe menaxhimin
- Bashkëpunim institucional për luftë efikase kundër korrupsionit
- Hapat e marra drejt drejtësisë ndërseksionale për të gjitha gratë dhe vajzat rome
- Trajnimi i IACA autorizon të gjithë punonjësit publikë që të bëhen agjentë proaktivë për ndryshime në fushën e korrupsionit
- „Bisedat për barazi “: Platforma për dialog dhe trajtim të sfidave strukturore dhe sistemike të barazisë
- Transformimi i aftësive mediatike: Komunikimi në raste krizash për grupin e punës të shërbimit të proves për marrëdhënie me publikun

Përparimi ne gjyqësor: Përparimi i Këshillit Gjyqësor në zbatimin e rekomandimeve nga Misioni Vlerësues i BE-së

Në fund të vitit 2023, në raportin e Misionit Vlerësues për Këshillin Gjyqësor u dhanë 17 rekomandime për përmirësim të zgjedhjes, emërimit dhe përgjegjësisë së gjykatësve dhe për rritje të transparencës dhe komunikimit të Këshillit. **Në korrik të vitit 2024, projekti ynë mbajti një konferencë ku Këshilli prezantoi përparimin e arritur në zbatimin e rekomandimeve të Misionit Vlerësues të BE-së.** Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësuesit më të lartë të gjyqësorit dhe bashkësisë ndërkombëtare, bashkë me shoqata juridike, oda juridike, gazetarë dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Gjatë kësaj konference, kryetarja e Këshillit Gjyqësor dhe dy anëtarë prezantuan aktivitetet e ndërmarra për të rritur funksionimin e Këshillit dhe gjykatave. Fokusi u vendos në menaxhimin efektiv dhe rritjen e transparencës. Për tu arritur kjo, gjatë vitit 2024 Këshilli mbajti dy punëtori të brendshme dhe dy publike, të gjitha me mbështetjen e projektit tonë, me qëllim të miratimit të Planit të Veprimit për Zbatim të Rekomandimeve të BE-së, ndryshim të akteve nënligjore dhe hartim të një Strategjie Komunikimi gjithëpërfshirëse pesëvjeçare të Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatave. Miratimi i këtyre dokumenteve thekson dedikimin e Këshillit për të zbatuar në tërësi rekomandimet e Misionit Vlerësues të BE-së me qëllim të rritjes së transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies të gjyqësorit.







Në këtë konferencë, ambasadorët e BE-së, SHBA-ve dhe Mbretërisë së Holandës përshëndetën përpjekjet e Këshillit dhe kapacitetin e rritur të tij për ta avancuar sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut.

Ata theksuan që reformat e radhës duhet të jenë sistematike, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me standardet e BE-së në mënyrë që të sigurohet gjyqësor funksional, transparent dhe i drejtë. Kjo perspektivë u përsërit edhe nga ekspertët që mbajtën prezantime, përfaqësues nga fusha e gjyqësorit, Iniciativa ,,Gjyqësori i Hapur'' dhe Këshilli Gjyqësor-Mediatik.

Aktivitetet e Këshillit tashmë kanë rezultuar apo pritet që të rezultojnë me rritje të cilësisë: evaluim më i mirë i punës së gjykatësve për avancim, vendime të elaboruara për emërime, përmirësim i procesit të ankesave për gjykatësit që nuk dakordohen me rangimin e marrë, përdorim i zgjidhjeve teknologjike (IT) gjatë procesit të avancimit të gjykatësve, afate më të shkurtra për zbatim të procedurave diciplinore, përfshirje më e madhe e Shoqatës së Gjykatësve dhe organizatave qytetare, raporte të arsyetuara nga seancat që janë me koncize dhe lexohen më lehtë, transmetim i drejtpërdrejtë i seancave dhe rritje e numrit të përmbajtjeve që publikohen në faqen e internetit të Këshillit.

Mbështetja si nga palët ndërkombëtare ashtu edhe nga ato të vendit vërteton dedikimin për avancim të sundimit të së drejtës në Maqedoninë e Veriut. Përparimi, angazhimi i vazhdueshëm për bashkëpunim, me mbështetje të vazhdueshme nga projekti ynë do të jenë thelbi për arritje të rritjes së cilësisë së gjyqësorit.







Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Trajnimi praktik i Darknet për prokurorët publikë dhe hetuesit në Maqedoninë e Veriut

Prokurorët publikë dhe hetuesit nga qendrat e hetimit të PP morën pjesë në trajnimin praktik për Darknet. Policët nga Republika e Sllovenisë ndanë përvojat nga puna e tyre me raste që lidhen me Darknet, mënyrat dhe mundësitë për të analizuar materiale dhe prova që merren përmes këtij rrjeti, hetimet penale dhe financiare, pagesat me kriptovaluta, duke prezantuar edhe shembuj praktikë.

Ky është një hap i madh përpara në luftën kundër krimit të organizuar dhe drejt forcimit të institucioneve në Maqedoninë e Veriut. Ky trajnim u organizua në bashkëpunim me Komponentin 1 – Rritja e kapacitetit të institucioneve të gjyqësorit për zbatim të së drejtës në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme dhe Komponentit 2 – Forcimi i kapaciteteve për zbatim efektiv të teknikave bashkëkohore të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar.



Këshilli për Ndjekje të Zbatimit të Reformave në Gjyqësi mbajti seancën inauguruese me të cilën forcohet dedikimi i aspiratave për tu bërë pjesë e BE-së

Këshilli për Ndjekje të Zbatimit të Reformave në Gjyqësi, që u formua në fund të marsit të vitit 2024, mbajti seancën inauguruese në 23 maj të vitit 2024, pak para formimit të kuvendit të ri. Pavarësisht vonesave, Këshilli me dokumentacionin e plotë përgatitur nga projekti ynë mori lëvdata nga ministri i drejtësisë Krenar Lloga, profesori Vllado Kambovski dhe nga Kryetari i Këshillit Gjyqësor për angazhimet e marra.

Qëllimi i këtij Këshilli është të sigurojë vazhdimësi në ndjekjen e reformave në gjyqësor, që janë thelbësore për aspiratat që Maqedonia e Veriut ka për tu bërë pjesë e BE-së. Ministri Lloga theksoi rëndësinë e miratimit të Strategjisë Sektoriale për Zhvillim në Gjyqësor (2024-2028), ku parashihet gjyqësor i pavarur, i përgjegjshëm dhe transparent që mbron të drejtat e njeriut dhe mbështet sundimin e ligjit.



Ky këshill do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit në kohë të masave që parashihen brenda Planit të Veprimit, ndjekjen e prioriteteve, afateve dhe vlerësimin e rezultateve. Me mbështetje nga ekspertët e projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'', eksperti Sllaven Lekiq gjatë seancës theksoi aktivitetet e ndërmarra që kjo Strategji të ketë sukses. Këshilli solli përfundimin që aktivitetet dhe ndjekja e reformave në gjyqësor duhet të vazhdojnë.

Projektit tonë iu nda pllakat për bashkëpunim dhe mbështetje nga Shoqata e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Gjatë shënimit të 25 vjetorit të Shoqatës së Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuesve të projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' iu nda pllakat për bashkëpunim të suksesshëm dhe mbështetje. Kjo mirënjohje thekson dedikimin që projekti ka për forcim të Prokurorisë Publike dhe për avancim të sundimit të ligjit.



Shoqata e Prokurorëve Publikë është organizatë joqeveritare, apolitike dhe jofitimprurëse me karakter vullnetar. Tashmë 25 vite me radhë vepron në fushën e promovimit të pavarësisë dhe paanshmërisë të prokurorëve publikë. Projekti ynë dhe kjo Shoqatë bashkëpunojnë për aktivitete që lidhen me vlerësimin e punës, procedurave mbikëqyrëse, procedurave diciplinore dhe transparencës së Prokurorisë Publike dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Pllakati shpreh dedikimin e përbashkët ndaj këtyre qëllimeve dhe ndikimin pozitiv që ka pasur bashkëpunimi. Projekti ynë falenderon Shoqatën për nderin dhe mirëpret partneritet të vazhduar në forcimin e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit.



Përgatiten ndryshimet e Rregullores për Procedurën Diciplinore

Projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' ka përmirësuar mjaft procedurat diciplinore në Prokurorinë Publike në Maqedoninë e Veriut (PP). Ekspertët e projektit kanë hartuar dy raporte: njëri për ligjet e vendit dhe tjetri për standardet ndërkombëtare. Dokumenti i dytë bën vlerësim të sistemit diciplinor në Maqedoninë e Veriut sipas standardeve evropiane, shqyrton praktikat e drejta dhe rekomandon përputhje të Ligjit për PP me Rregulloren për Procedurën Diciplinore.



Projekti ynë organizoi tryezën e rrumbullakët për diskutim mbi këto raporte, ku morën pjesë palët relevante, përfshirë këtu edhe Prokurorin Publik dhe anëtarët e Komisionit Diciplinor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Një rezultat i rëndësishëm ishte vendimi për ndryshim të Rregullores për Procedurën Diciplinore.

Për tu mbështetur ky proces, projekti mbajti punëtori dyditore me prokurorët publikë, anëtarët e Komisionit Diciplinor dhe përfaqësues nga Shoqata e Prokurorëve Publikë. Pjesëmarrësit bënë vlerësim të ligjeve ekzistuese dhe propozim-ndryshimeve, gjë që rezultoi me hartimin e amandamenteve për harmonizim të Rregullores me Ligjin aktual për PP dhe standardet ndërkombëtare.

Me këto qëllime synohet që të arrihet siguri juridike, procedurë në kohë dhe mbrojtje juridike për prokurorët deri në miratimin e një Ligji të ri për PP.

Punëtoria arriti qëllimin e ndërtimit të konsesusit për propozim-ndryshimet, përshpejtim të procesit të mbështejtjes të grupit të punës dhe respektimit të afateve në Strategjinë Zhvillimore Sektoriale për Gjyqësorin dhe Planin e Rritjes.



Bashkëpunimi efektiv mes Avokatit të Popullit dhe autoriteteve lokale në Kavadar forcon të drejtat e njeriut dhe qeverisjen

Gjatë diskutimit në tryezën e rrumbullakët në Kavadar në 17 maj të vitit 2024, pjesëmarrësit theksuan përfitimet nga bashkëpunimi efektiv mes autoriteteve lokale dhe institucionit të Avokatit të Popullit. Nga ky bashkëpunim përfitojnë qytetarët dhe administrata lokale ngaqë forcohet mbrojtja e të drejtave të njeriut, rritet cilësia e praktikave administrative dhe forcohet sundimi i ligjit. Kjo ngjarje, që u mbajt në ndërtesën e komunës, bëri bashkë Avokatin e Popullit Naser Ziberi, Kryetarin e Komunës së Kavadarit Mitko Jançev, ekipet e tyre dhe përfaqësues të shoqërisë civile për të shqyrtuar përparimin, sfidat dhe mundësitë e planifikimit urbanistik, çështje që lidhen me mjedisin jetësor, arsimimin dhe punën.



Udhëheqësit në administratën komunale prezantuan arritjet dhe diskutuan mbi pengesat që kanë për të zbatuar rekomandime të caktuara. Një sfidë që u theksua ishin ndërtimet pa leje, që vë në pah nevojën për përpjekje të koordinuara mes autoriteteve lokale dhe atyre qendrore. Zëvendës Avokati i Popullit Liljana Ilievska përshëndeti zbatimin e suksesshëm të mbi 90% të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Sasha Jankoviq, ekspert i projektit, ofroi rekomandime nga praktikat evropiane për të avancuar bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit.

Ndotja e mjedisit jetësor mori vëmendje të veçantë, me çka Kryetari i Komunës prezantoi planet se si mund të zgjidhet, kurse përfaqësuesit e Avokatit të Popullit paralajmëruan theks të veçantë për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kjo ngjarje forcoi bashkëpunimin mes Avokatit të Popullit dhe administratës lokale të Kavadarit, duke vendosur kanale të reja komunikimi për mirëkuptim të sfidave praktike dhe shqyrtim të përfitimeve që sjell bashkëpunimi i forcuar.

Mediet e agjencisë nacionale të lajmeve transmetuan këtë praktikë në nivel nacional, duke inkurajuar këto lloje iniciativash. Kjo ngjarje dëshmoi që komunat e organizuara mirë me profesionistë të kualifikuar, me udhëheqësi të përgjegjshme dhe me bashkëpunim të fortë me OJQ-të mund të zbatojnë në mënyrë efikase rekomandimet që jep Avokati i Popullit. Planet për të ardhmen kanë për qëllim të promovojnë modelin e suksesshëm të Kavadarit nëpër komuna të tjera, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e Kavadarit nëpër diskutime për të ndarë përvojat e tyre dhe për të nxitur bashkëpunime të ngjashme edhe nëpër qytete të tjera.






Bashkëpunimi institucional për luftë efikase kundër korrupsionit

Si konkluzë e ngjarjes ,,Të bashkuar kundër korrupsionit: Forcimi i sinergjisë së gjyqësorit dhe organeve që zbatojnë ligjin në luftën kundër korrupsionit'' organizuar nga projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' mund të merret ndarja e praktikave të mira dhe strategjive inovative në luftën kundër korrupsionit nga ekspertët e policisë sllovene, si dhe inicimi i bashkëpunimit institucional në politikat për antikorrupsion në Maqedoninë e Veriut.

Ngjarjen e hapi Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që tha se lufta kundër korrupsionit ka domethënie të madhe për përparimin e mëtejshëm të vendit. „Edhepse jemi vend i vogël, jam më se i sigurt që mund të kontribuojmë në Bashkimin Evropian“, shtoi Toshkovski.



Gjatë kësaj ngjarjeje, Dr. David Smolej dhe Mr. Matjazh Jerkiq, ekspertë sllovenë, ndanë përvojat e tyre praktike në luftën kundër korrupsionit. Smolej theksoi rëndësinë e aspekteve juridike dhe organizative për përpjekjet e antikorrupsionit në Slloveni dhe në Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër, Jerkiq diskutoi mbi përdorimin e masave të posaçme hetimore në hetimet e krimeve korruptive dhe zbatimin e tyre efektiv. Në këtë diskutim kishte edhe ndarje të përvojave dhe rekomandimeve mbi praktikat më të mira nga Sllovenia që mund të zbatohen edhe në sistemin tonë. Dr. Sasho M. Stojanovski, nga Prokuroria Publike në Shkup, foli edhe për masat e posaçme hetimore që japin pasqyrë të kornizës ligjore për luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut. U theksua rëndësia e bashkëpunimit institucional në luftën kundër korrupsionit tek ne, kurse përvojën mbi këtë fushë e ndau edhe Servet Demiri, anëtar i Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK).



Ky takim ishte jo vetëm një platformë për të ndarë praktikat më të mira dhe strategjitë inovative, por edhe një nxitje për të inicuar ndryshime të dukshme në politikat e antikorrupsionit në Maqedoninë e Veriut.

Kjo ngjarje u moderua nga Mr. Mojca Kuzmicki, eksperte për luftën kundër korrupsionit dhe larjes së parave, angazhuar nga projekti.





Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Hapat e marra për drejtësi ndërseksionale për të gjitha gratë dhe vajzat rome

Në 27 maj të vitit 2024, projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' bashkë me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) organizoi takimin koordinativ ,,Statusi i implementimit të aktiviteteve na Plani Nacional i Veprimit (PNV) për Mbrojtje, Promovim dhe Përmbushje të të Drejtave të Grave dhe Vajzave Rome (2022-2024)". Ky takim u mbajt në Klubin e Deputetëve.

Ngaqë është periudha e vlerësimit të përparimit të arritur me implementimin e Planit Nacional të Veprimit për Mbrojtje, Promovim dhe Përmbushje të të Drejtave të Grave dhe Vajzave Rome (2022-2024) (PNV), ky takim u organizua me dy qëllime. Qëllimi i parë ishte forcimi i koordinimit, implementimit dhe ndjekjes për të evituar përsëritjen e aktiviteteve të ndërmarra apo të planifikuara si pjesë e implementimit të PNV. Qëllimi i dytë ishte identifikimi i prioriteteve që duhet të jenë pjesë e Planit Operativ për PNV për vitin 2024.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga institucionet e vendit, institucionet nacionale për të drejtat e njeriut, organizata joqeveritare (OJQ), donatorë dhe organizata ndërkombëtare dhe aktivistë që veprojnë në fushën e barazisë së grave dhe vajzave rome.



Pjesëmarrësit prezantuan aktivitetet e realizuara të cilat pjesërisht apo tërësisht u dedikohen grave dhe vajzave rome dhe të drejtave të tyre. Ata prezantuan edhe planet për aktivitetet e ardhshme. Atmosfera e forumit të hapur mundësoi diskutime aktive, moderuar në mënyrë maestrale nga Mabera Kamberi (MPPS).



Kështu, në hollësi u shqyrtua ajo që është implementuar nga PNV dhe ajo që mbetet për tu bërë. Me ide për gjërat që duhet të mbarohen, pjesëmarrësit propozuan prioritete që duhet të bëhen pjesë e Planit Operativ për Implementim të PNV për vitin 2024.

Pas këtij takimi, ekspertja e projektit për barazi gjinore, Dr. Biljana Kotevska, mbështeti MPPS me hartimin e Planit Operativ. Teksti i draftit u përpilua bashkarisht, me dialog me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë. Pasi u përfundua, dokumenti draft iu dërgua të gjithë pjesëmarrësve në takim për tu shqyrtuar, dhe pastaj teksti u përmbyll në versionin përfundimtar në 16 korrik të vitit 2024. Hapi i radhës është që MPPS të dorëzojë Planin Operativ për tu miratuar në Qeveri.

Kjo është ngjarja e dytë që organizojmë me fokus tek gratë dhe vajzat rome. Si ngjarje pasqyron premtimin e fortë që projekti ka dhënë për të kontribuar sa më shumë në zbatimin e suksesshëm të NPB dhe në mbështetjen e punës së MPPS për gratë dhe vajzat rome. Kjo ngjarje është një hap i rëndësishëm përpara në përpjekjet tona të përbashkëta për të promovuar drejtësinë ndërsektoriale – dedikimi drejt sigurimit të qasjes së barabartë në drejtësi, mundësi dhe resurse dhe fuqi shoqërore për të gjithë, përfshirë këtu edhe gratë dhe vajzat rome.

Trajnimi i IACA emancipon punonjësit publikë që të bëhen agjentë propaktivë për të sjellur ndryshime në fushën e korrupsionit

Trajtimi efektiv i korrupsionit kërkon më shumë se ligje të fuqishme dhe dënime. Duhen edhe njerëz të informuar mirë dhe të angazhuar për të identifikuar dhe për t'iu kundërvënë praktikave korruptive. Pikërisht këtu është roli thelbësor i arsimimit dhe edukimit ngaqë ashtu individët inkurajohen që të bëhen agjentë proaktivë për ndryshime në bashkësitë e tyre dhe mjediseve profesionale përmes nxitjes së kuptimit të thellë të mekanizmave dhe pasojave nga korrupsioni.



Akademia Ndërkombëtare për Antikorrupsion (IACA) njeh rolin e rëndësishëm që edukimi i specializuar ka në luftën kundër korrupsionit. Kjo Akademi ofron program edukativ rigoroz, të shumëllojshëm dhe inovativ të planifikuar për të siguruar pasqyrë gjithëpërfshirëse të sistemeve të korrupsionit, antikorrupsionit, integritetit dhe përputhshmërisë. Qasja gjithëpërfshirëse që ka Akademia integron perspektivat ndërkombëtare interdiciplinore, integrative dhe ndërsektoriale, duke shpërfaqëur kështu kompleksitetin e sfidave të sotshme që lidhen me korrupsionin.

Për këtë arsye, projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'', në dhjetor të vitit 2023 nënshkroi marrëveshje me IACA-n që na mundësoi të shfrytëzojmë ekspertizën e tyre të veçantë dhe të mbajmë kurse akademike të nivelit të lartë për punonjësit publikë në Maqedoninë e Veriut.

Kursi i parë nga katër kurset gjithsej u mbajt në maj-qershor 2024 dhe kishte të bëjë me parregullshmëritë organizative. Në të morën pjesë 20 persona nga 11 institucione që dhanë provimin e kursit onlajn. Që të gjithë pjesëmarrësit kaluan testin përfundimtar dhe morën certifikatën e IACA-s.



Pavan Kumar Sina, drejtori i programeve akademike në IACA, foli për këtë trajnim duke theksuar se ,,Të gjithë pjesëmarrësit dëshmuan entuziazëm të madh për të mësuar mbi parimet e parregullshmërive organizative dhe udhëheqjes etike në kuadër të studimeve për antikorrupsion. Pjesëmarrësit ishin mjaft të përgatitur dhe morën pjesë në diskutime të rëndësishme. Ishte kënaqësi të organizosh trajnim për një grup kaq të përgatitur zgjedhur nga udhëheqësja e komponentit dhe ekipit të saj në kuadër të projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'', në Maqedoninë e Veriut.

Edhe pjesëmarrësit vlerësuan trajnimin si të shkëlqyer. Elena Dimovska, udhëheqëse e Sektorit për Koordinim të Aktiviteteve për Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë thotë: ,,Ky kurs kaloi pritjet që kisha sa i përket cilësisë së ligjeratave dhe materialeve. Është mjaft relevant dhe i dobishëm për të mbështetur proceset e menaxhimit me rrezikun në institucionet tona. Ligjeruesi tregoi shumë interes dhe kujdes dhe ofroi mundësi të shkëlqyera për interaksion dhe rrjetëzim me pjesëmarrësit e tjerë."

Kursi i radhës i IACA-s që do të fillojë në shkurt të vitit 2025 ka të bëjë me hetimet që bazohen ne baza të hapura të të dhënave dhe hetimet e brendshme. Për thirrjen e ardhshme për tu paraqitur na ndiqni gjatë muajve në vijim.

„Bisedat për barazi“: Platformë dialogu për trajtim të sfidave strukturore dhe sistemike të barazisë

Projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' me krenari thekson që bashkë me Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi përpiloi dhe organizoi platformën e parë të hapur për dialog dhe trajtim të sfidave strukturore dhe sistemike për barazi dhe mos-diskriminim – „Bisedat për barazi “. Me këtë ngjarje që planifikohet si ngjarje vjetore, duhet të sigurohet dialog mes palëve relevante për tu përkufizuar mënyrat konkrete dhe praktike për zbatim të rekomandimeve që kanë karakter të përgjithshëm, me qëllim që të theksohet ekzistenca e çështjeve madhore, sistemike apo strukturore. Zgjodhëm titullin ,,Bisedat për barazi'' që të theksojmë që edhe bisedat janë për barazi dhe që barazia është ajo që ka fjalën kryesore këtë ditë, pra qëllimi i barazisë ka vendin qendror.

Tema e botimit të parë, ,,Arsimi gjithëpërfshirës'', u zgjodh nga KPMD. Zgjedhja u bë sipas praktikës së tyre gjyqësore, vlerësimit të tyre për çështje urgjente sistemike dhe rekomandimeve që u dhanë gjatë rezultateve të ndryshme.

Në këtë ngjarje kishte dy panele me nga tetë panelistë, dy fjalime që u mbajtën nga dy ekspertë ndërkombëtarë, dy sesione në qendër të vëmendjes që u mbajtën nga tri anëtarë dhe të punësuar në KPMD dhe një sesion hyrës dhe një përfundimtar.



Në hapje fjalë përshëndetëse mbajtën kryetari i KPMD – Igor Jadrovski, Ministrja e Arsimit dhe Shkencës – Vesna Janevska dhe udhëheqësja jonë e K4 – Barbara Ligel. Të gjithë folësit shprehën dedikimin e fuqishëm për zgjidhje të sfidave aktuale me arsimin gjithëpërfshirës dhe rolin qendror që barazia duhet ta ketë në këtë fushë.

Fjala e rastit u mbajt nga Dr. Lila Farkas, me ne fokus arsimin gjithëpërfshirës në praktikën dhe ligjet ndërkombëtare dhe evropiane. Ajo theksoi rëndësinë e respektimit të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kur bëhet fjalë për arsimin gjithëpërfshirës, sidomos ato ligje që dalin nga OKB-ja.

Fjala e dytë u mbajt nga Justina Joneski, që prezantoi perspektivën gjinore për arsimin gjithëpërfshirës me fokus tek standardet krahasuese evropiane dhe përvojat duket elaboruar në mënyrë të detajuar historinë e suksesshme mbi procesin gjyqësor para Gjykatës Kushtetuese në Rumani.

Të dy panelet vendosën në fokus arsimin gjithëpërfshirës në nivel nacional. I pari kishte të bëjë me konceptin e arsimin gjithëpërfshirës dhe sfidat aktuale në përgjithësi, kurse i dyti kishte në fokus arsimin që merr parasysh çështjet gjinore dhe pse kjo çështje është aktuale në vendin tonë. Në fund, me qëllim që të sigurohet vëmendja e nevojshme për KPMD dhe përpjekjet e tyre, ngjarja mbajti dy sesione me ,,Komisionin në fokus'', ku anëtarët dhe të punësuarit në KPMD prezantuan atë që ky organ barazie ka bërë deri tani për arsimin gjithëpërfshirës në përgjithësi dhe për arsimin që merr parasysh çështjet gjinore.

Ekspertja e projektit për barazi gjinore, Dr. Biljana Kotevska, mbështeti KPMD në planifikimin dhe përgatitjen e ngjarjes dhe gjatë hartimit të raportit mbi këtë ngjarje. Do të vazhdojmë të mbështesim KPMD gjatë përgatitjes së planit të aktiviteteve që do të bazohen në rekomandimet dhe rezultatet e ngjarjes dhe tek raporti mbi ngjarjen. Poashtu, do të vazhdojmë të mbështesim edhe punën e ,,Bisedave për barazi'' gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.



Kjo ngjarje dëshmoi dedikimin që ne kemi ndaj KPMD – një institucion që po shndërrohet në një forcë të dukshme për barazi dhe për ndryshime më të gjera shoqërore në vend.


JUDICIARY
POLICE
HUMAN
Funded by the European Union

Transformimi i aftësive mediatike: Trajnim i grupit të punës për marrëdhënie me publikun gjatë shërbimit të provës për komunikim në rastë krizash

Në fund të muajit maj të vitit 2024, dymbëdhjetë anëtarë të grupit të punës për marrëdhënie me publikun nga shërbimi i provës u takuan në Veles në një trajnim të rëndësishëm për komunikim në raste krizash dhe teknika për intervistim. Kjo punëtori dyditore që u udhëhoq nga eksperti ndërkombëtar me qëndrim të shkurtër për marrëdhënie me mediet dhe komunikim në raste kriazh, Millosh Gajiq, kishte në fokus rritjen e aftësive të pjesëmarrësve për të trajtuar interaksionet me mediet dhe menaxhimin efikas me komunikimin në raste krizash.

Gjatë ditës së parë fokusi ishte në komunikimin në raste krizash. Pjesëmarrësit u përfshinë me ushtrime për të kuptuar rëndësinë që kanë porositë e qarta dhe të mirë-organizuara. Një aktivitet veçanërisht i rëndësishëm ishte krahasimi i perceptimeve të ndryshme për fotografi të ngjashme, duke theksuar se si perspektivat e ndryshme mund të ndikojnë në komunikim. Grupi diskutoi mbi kriza të mundshme që do të mund të ndikonin në institucionin e tyre, duke zhvilluar protokolle të përshtatura për komunikim dhe strategji për tu ballafaquar me skenare të përmasave të mëdha.

Gjatë ditës së dytë fokusi ishte tek teknikat e intervistave me mediet. Pjesëmarrësit diskutuan mbi përvojat e tyre të mëparshme me mediet, duke trajtuar të drejtat po edhe obligimet e tyre gjatë intervistave. Ata ushtruan se si jepen deklarata koncize për mediet dhe mësuan mbi artin e ,,tejkalimit'' për të drejtuar interaksionet e medieve në kahje të përshtatshme. U simulua një konferencë për shtyp, ku pjesëmarrësit zbatuan aftësitë e reja në atmosferë reale sfiduese.

Reagimet e pjesëmarrësve ishin vërtetë pozitive. Një nga të pranishmit theksoi: ,,Pjesëmarrja interaktive dhe puna në grupe ishin momentet më të rëndësishme të këtij trajnimi''. Një tjetër tha: „Stili i trajnerit arriti të mbajë interesin tim gjatë gjithë trajnimit ". Ushtrimet praktike, sidomos konferenca e simuluar për shtyp, u përshëndetën për relevancën dhe zbatueshmërinë e menjëhershme.

Pjesëmarrësit përfunduan trajnimin me ndjenjë sigurie dhe gatishmërie për të zbatuar aftësitë e reja. „E para gjë që kam në plan të zbatoj është njohuria e marrë mbi komunikimin në raste krizash", deklaroi njëri nga pjesëmarrësit. Një tjetër theksoi rëndësinë e teknikave të intervistimit duke thënë: „Do t'i përdor teknikat e intervistimit gjatë interaksioneve të ardhme me gazetarët". Kërkesën për sesione të ardhshme për të folurit në publik e thekson edhe suksesi i trajnimit dhe dedikimi që pjesëmarrësit treguan për përmirësim të vazhdueshëm.

Trajnimi për komunikim në raste krizash dhe teknika të intervistimit jo vetëm që plotësoi, por edhe tejkaloi pritjet e pjesëmarrësve. Prezantimet e mirëstrukturuara, sesionet interaktive dhe ushtrimet praktike siguruan përvoja të çmuara të nxënies. Ky trajnim rriti mjaft kapacitetet e pjesëmarrësve, duke iu ofruar atyre aftësi bazë për të naviguar gjatë interaksioneve me mediet dhe menaxhimit efikas me krizat.

Ky trajnim është dëshmi për dedikimin e ndërtimit të kapaciteteve komunikative në kuadër të shërbimit të provës dhe në këtë mënyrë anëtarët e grupit të punës për marrëdhënie me publikun janë më të përgatiur për sfidat e të ardhmes.





SHPLLAJT Robert

INTERVISTË

NJIHUNI ME EKIPIN

UDHËHEQËSI I KOMPONENTIT

Krijimi i strategjive inovative dhe vendosja e teknologjive të avancuara për rritjen e luftës kundër krimit të organizuar në Maqedoninë e Veriut

Запознајте го тимот: Сесијата за интервју е креиерана за да ве запознае со членовите на тимот од проектот „Поддршка на ЕУ за владеење на правото“.

Zoti Robert Shpllajt vjen me njohuri të madhe dhe përvojë praktike në fushën e sundimit të ligjit dhe zbatimit të tij. Ka qenë pjesë e disa projekteve të BE-së në Ballkan dhe ka një rrjet të madh kontaktesh në rajonin e Evropës Juglindore. Gjatë karriesës së tij të gjatë policore në Slloveni, ai ka fituar shumë përvojë në fushën e krimit të organizuar, duke udhëhequr ekipin për luftë kundër krimit të organizuar, bashkëpunim me autoritete të huaja për zbatim të ligjit dhe realizim të detyrave më të komplikuara kundër krimit të organizuar, si dhe zbatim të hetimeve për vepra të komplikuara dhe përgatitje dhe propozim të zgjidhjeve sistemore për çështjet urgjente.

Si udhëheqës i Komponentit 2 që ka në fokus luftën kundër krimit të organizuar në Maqedoninë e Veriut brenda projektit Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit, si përkufizoni ju sundimin e ligjit në këtë kontekst?

Do theksoja tri parime kryesore për mua, dhe atë:

Parimet themelore juridike
Sundimi i ligjit garanton që ligji zbatohet drejtë dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë. Në këtë drejtim, kjo do të thotë që grupet e organizuara kriminele në Maqedoninë e Veriut duhet të mbajnë përgjegjësi sipas kornizës ligjore, pa anshmëri dhe pa favorizime. Kjo kërkon zbatim të përpiktë dhe procedura transparente juridike.

Zbatimi efikas i ligjit
Sundimi i ligjit përfshin autorizim të institucioneve që zbatojnë ligjin që të hetojnë, të ndjekin dhe të shkatërrojnë në mënyrë efektive rrjetet kriminele. Këtu bën pjesë edhe sigurimi i trajnimeve adekuate dhe resurseve si dhe sigurimi i koordinimit të fuqishëm mes institucioneve që të mbrohen standardet juridike dhe që të luftohet krimi i organizuar.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut
Sundimi i ligjit kërkon respektim të të drejtave të njeriut gjatë procesit gjyqësor. Respektimi i të drejtave të çdo individi, përfshirë këtu edhe të dyshuarit apo të akuzuarit, janë thelbësore kur bëhet fjalë për krimin e organizuar më qëllim që të ruhet besimi i opinionit dhe integriteti i sistemit juridik.

Brenda komponentit tuaj u organizuan dy vizita studimore në Sllloveni me policë nga Maqedonia. Si ndikoi kjo tek pjesëmarrësit?

Të dy vizitat studimore në Sllloveni ishin të rëndësishme për avancim të aftësive dhe njohurive të policëve. Gjatë këtyre vizitave pjesmarrësit morën njohuri të rëndësishme për strategji efektive policore dhe praktika më të mira që përdoren në Sllloveni, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në qasjen që ata kanë në punën e tyre.

Poashtu, gjatë këtyre vizitave u forcuan rrjetet profesionale dhe u krijuan mundësitë për bashkëpunim të vazhdueshëm mes institucioneve maqedonase dhe sllovene për zbatim të ligjit. Ky partneritet i forcuar pritet që të rritet me angazhimet e tyre kolektive në luftën kundër krimit të organizuar në Maqedoninë e Veriut.

Kryesisht, vizitat studimore ndikojnë pozitivisht, pjesëmarrësit mësojnë mbi instrumente dhe strategji të reja dhe forcojnë dedikimin për të arritur qëllime të përbashkëta ne luftën kundër krimit të organizuar.

Në komponentin tuaj ka misione nga ekspertë sllovenë në fusha të ndryshme siç janë teknikat bashkëkohore të hetimit në kuftën kundër krimit të organizuar. A mund të ndani ndonjë aftësi apo teknikë që policët maqedonas kanë mësuar nga kolegët sllovenë? Në qoftë se bëhet fjalë për të dhëna konfidenciale, a mund të paktën të na thoni se si zbatohen këto aftësi?

Patjetër. Brenda komponentit 2 duam të ofrojmë qasje gjithëpërfshirëse dhe sistemore në luftën kundër krimit të organizuar. Këtu bëjnë pjesë të gjitha njësitë dhe përdorimi i gjithë teknologjisë së avancuar, siç është skyECC. Funksionimi bazë i komunikimit skyECC, ku përfshihen përvoja e ekspertëve sllovenë në analizën e këtij komunikimi të fshehtë, u prezantua para disa njësive në formë të prezantimeve. Si pjesë e prezantimeve dy sektore u informuan mbi mundësitë/si mund të hetojnë akte kriminele duke përdorur komunikimin skyECC.

U dhanë këshilla se si të bëhet kontrolli dhe si të punohet më këtë lloj komunikimi. Po ju tregoj disa nga këshillat bazë mbi atë se si të qaseni në një sasi të madhe të informacioneve të marra:

Pasi merren pakot e para me të dhëna (përmes Europolit për qëllime operative apo përmes Eurodrejtësisë për qëllime provash), çdo pjesëmarrësi i duhet mbështetje bazë analitike për tu futur në analizë dhe punë konkrete. Implementimi i këtillë bën që të evitohen shumë komplikime analitike/teknike dhe mundëson qasjen më efikase dhe të vërtetuar drejt analizës së përmbajtjes të të dhënave, që në fakt përbën analizë të vetë përmbajtjes së porosive të këmbyera bashkë me meta të dhënat. Shtrirja e këtyre porosive mund të jetë shumë e madhe, prandaj qasja e gabuar bën që vlerësimi i përmbajtjes të marrë shumë kohë, por mund të rezultojë edhe si joefikas.

E ardhmja do tregojë se a respektohen këto udhëzime dhe udhëzimet e tjera.

Lufta kundër krimit të organizuar është pa dyshim një sfidë e madhe. Mund të ndani ndonjë moment kur jeni ndjerë krenarë për përparimin që po bën Maqedonia e Veriut?

Një moment krenarie ishte kur u shpërbë një rrjet i madh i krimit të organizuar me përpjekje të koordinuara mes autoriteteve maqedonase dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ky operacion jo vetëm që solli mjaft arreste, por edhe dëshmoi efektivitetin e strategjive dhe trajnimit të bërë. Ishte një provë e qartë për përparimin që po bëhet dhe për forcën e angazhimeve tona të përbashkëta që po rritet dita ditës.


Në qoftë se ju kërkohet të përshkruani bashkëpunimin mes Komponentit tuaj dhe institucioneve përfituese me një fjalë, cilën fjalë do e kishit zgjedhur dhe pse?

Në qoftë se më kërkohet që me një fjalë të përshkruaj bashkëpunimin mes Komponentit tonë dhe institucioneve përfituese, ajo fjalë do të ishte ,,sinergjia''. Ky term shpërfaq mënyrën se si angazhimet tona të përbashkëta kombinojnë forcat, resurset dhe ekspertizën për të arritur përparim të madh në luftën kundër krimit të organizuar.

Cilat strategji apo qasje jeni të gatshëm t'i mbështesni gjatë luftës së vazhdueshme kundër krimit të organizuar në Maqedoninë e Veriut në të ardhmen?

Në të ardhmen, me kënaqësi të veçantë mbështes integrimin e teknologjive të avancuara dhe analitikën e të dhënave në strategjitë tona. Duke përdorur mjetet më bashkëkohore për mbledhje të të dhënave të kundërzbulimit në kohë reale dhe me analizë parashikuese, mund të rrisim aftësitë për parashikim më efektiv dhe për luftë më efektive kundër krimit të organizuar. Poashtu, promovimi i bashkëpunimit më të madh ndërkufitar dhe ndarja e njohurive do forcojë më tutje përpjekjet tona. Këtu bëjnë pjesë edhe hetimet financiare, që zbatohen paralelisht me hetimet, kriptovalutat, sektorin e punës sekrete, korrupsioni dhe larja e parave dhe teknika të tjera të avancuara. Këto qasje inovative premtojnë shumë për avancimin e luftës kundër krimit të organizuar në Maqedoninë e Veriut.





GUSHT - NËNTOR 2024

KALENDARI NGJARJET E RADHËS

SHTA

Tryezë e rrumbullakët për ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor

Komponenti 1

TET

Rritje e vetëdijes për lobim në sektorin privat

Komponenti 3

25 SHTA

27 SHTA

Ofrohet trajnim provë për shitësin

Komponenti 4

11 SHTA

Mbështetje e Strategjisë së parë Nacionale dhe Planit të Veprimit për Krimin Kompjuterik

Komponenti 2

26 SHTA

Takim me grupin ndërinstitucional të punës për forcim të rekomandimeve të KPMD

Komponenti 4





Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Botimi: Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit, Raporti i dytë tremujor, Lajme të mira nga Sundimi i Ligjit

Periudha e raportimit: 08 maj - 07 gusht 2024

Redaktuar nga: Kristina Vesikj, Zyrtare e Vizibilitetit

Data e botimit: Shkurt 2024

Adresa: Vasil Gllavinov 14, Shkup 1000

E-mail: kristina.vesikj@rolaw.mk

Financuar nga Bashkimi Evropian